



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1858 Prot.

Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 88, datë 01.08.2025

“PËR

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI TË KAPACITETEVE AKADEMIKE PËR
UDHËHEQJE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
“DOKTORATË” NË “SHKENCA SPORTIVE” PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”**

Mbështetur në nenet 35, 38, 77 paragrafi 4, 79 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në VKM nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Udhëzimin e MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 64 të Rregullores së UST-së, në nenin 9, pika 5 të Rregullores për Organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë “Doktoratë” në UST, e ndryshuar, në shkresën nr. 1730/5 Prot., datë 15.07.2025 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Senati Akademik

VENDOSI:

1. Të zëvendësohet Prof.Asoc. Bashkim Delia si kapacitet akademik për udhëheqje në programin e ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Sportive” për vitin akademik 2021-2022, si pasojë e dorëheqjes për shkak të daljes në pension (shkresa Nr.1730/1 Prot., datë 14.07.2025).
2. Të miratojë Prof.Asc. Elton Spahiu si kapacitet akademik për udhëheqje në ciklin e tretë “Doktoratë” në programin “Shkenca Sportive” për vitin akademik 2021-2022.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. AGRON KASA

